

POEZIA «QIELLI» E NAIMIT - NJË MODEL I GJUHËS POETIKE

Shefkije ISLAMAJ
Prishtinë

KUD: 809.198.3:800[82...A/21/71].08
Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Poezia lirike e Naim Frashërit është interesante për vështrim edhe nga aspekti lingvistik, në të vërtetë, ajo paraqet një model gjuhësor të përshtatshëm për analiza gjuhësore e stilistike. Në këtë vështrim janë bërë përpjekje të veçohen bartësit kryesorë të mesazhit dhe përbërësit thelbësorë të shprehjes poetike – gjuhësore. E veçanta e kësaj poezie janë paralelizmat (cilësorë paralelë e grupe sintagmatike paralele) dhe harmonia e shkëlqyer poetike e krijuar nga disa segmente morfologjike, leksematike e fonologjike.

Për studimin e veprës letrare, në këtë mes të poezisë, besoj se është e rëndësishme përpjekja që në strukturën e një poezie tipike lirike të përcaktohen bartësit kryesorë të mesazhit, të konstatohen fenomenet që formësojnë mesazhin, dhe që në bazë të shqyrtimit të tyre, të gjendet një rrugë vetjake për studimin e poetikës dhe të gjuhës së saj. Një përpjekje, një sprovë të tillë po ua ofrojmë lexuesve.

Në Shqipërinë e kohës së Naimit më shumë janë dëgjuar topat se ç'kanë kënduar muzat. E dihet, kur kërcasin topat, muzat heshtin. Megjithatë në Shqipërinë e topave, në Shqipërinë e lodhur e të brishtë, në Shqipërinë që po përpëlitej t'i merrte këmbët nga zinxhirët e rëndë të shekujve otomanë, një muzë, për fat jo e vetmja, po shpaloste mrekullueshëm botën e vet mendimore e ndjenjore, po shpaloste dashurinë, dëshirat e vizionet për trenomin e shenjtë Shqipëri, shqiptar, liri; po shpaloste poetin e madh të shekujve shqiptarë, që po i bënte hije mbrojtëse dje, krenari e shtysë sot. Sheli ka pasur të drejtë kur pat thënë se për çkado që flet poeti, ai është gjithmonë pasqyrë e hijes, të cilën ardhmëria ia hedh të sotmes. Poeti është kasnec i ardhmërisë, Promethe që vjedh fatin. Ndonëse njeriu, përkundër të gjithave, lind dhe vdes, pavarësisht se çfarë është jeta e tij, Naimi na bind se njeriu nuk vdes, madje rilind çdo ditë. Prandaj e ndiejmë sot aq afër nesh. Ai është këtu,

fare pranë nesh: i ri e i madh me idetë, i pa mplakur me artin, aktual me vizionet.

Naimi kishte një plan, një program krijues. Nuk është fjala për nismë të zakonshme ose për plan-ide spontane për krijimin e një vepre letrare, por për program më shumë se letrar, për program politik e kombëtar përmes artit. Anëvështrimi i tij e tej pamja e tij, janë aktuale për botën shqiptare, edhe për prirjen politike, më në fund edhe për fenë.

Edhe pse ideator shekullor, ai është edhe besimtar. Do të parapëlqejë tema universale, tema të pakapshme për njeriun, tema filozofike. Çdo shkrimtar ka një model nga niset, një objekt - simbol rreth të cilit sillet në krijimtarinë e tij. Në poezinë e tij «*Qielli*»¹ përmes së cilës po lexojmë mendjen e shpirtin e poetit, objekt - simbol është Perëndia, objekt - simbole ndihmëse - njeriu, qielli. Pikëpamja e veçantë për raportet zot - njeri i ka ndihmuar të krijojë koncepte universale. Për lexim gjuhësor e stilistik është zgjedhur, pikërisht, kjo poezi, jo pse paraqet veçanti të jashtëzakonshme poetike, madje mund të thuhet se ajo nuk dallon shumë nga poezitë e tjera të Naimit me këtë temë, por për shkakun se paraqet një model gjuhësor të përshtatshëm për analiza çfarë na interesojnë, analiza që kanë për qëllim të zbulojnë botën krijuese të një shkrimtari të madh, siç është Naimi ynë. Poezia «*Qielli*» nuk mund të vendoset lehtë në skema të qëndrueshme dhe të vlerësohet me kriteret standarde, të pranuar për një tip tjetër të poezisë dhe të një strukture tjetër. Ajo që e bën poezinë «*Qielli*» të veçantë e joshëse për linguistin janë paralelizmat si konstante thelbësore të saj, që përvijohen si një fill i pashkëputshëm në gjithë përbërësit e saj letrarë e jashtëletrarë. Paralelizmat na shfaqen me parimësi e me rregullsi në gjithë poezinë, në të gjitha rrafshet e ligjërit. Çiftet hetohen në leksik e në sintaksë (cilësorët paralelë dhe grupet sintagmatike paralele); si veçori stilistike eksplicite shquhen sidomos paralelizmat në krahasimet, në rrafshet të ndryshme, edhe në rrafshin e ideve e asociacioneve: subjektet na paraqiten në çifte kundërvënëse e përplotësuese; hetohen rryma paralele të shpërthimit të ndjenjave.

¹ Poezia *Qielli* e Naim Frashërit është botuar në përmbledhjen poetike në persishte *Tehajlat*, botuar në Stamboll më 1885 dhe përkthyer mrekullisht nga Vexhi Buharaja. Vexhi Buharaja, si njohës i pashoq i kulturës lindore, me përkthimin e veprave të Naimit të shkruara në persishte, dëshmon përgatitje të lakmueshme gjuhësore, leksikore - letrare dhe shije të hollë si artist e përkthyes. Këtë e dëshmon mirë, më në fund, edhe poezia *Qielli* e cila në shqipen na ofron një përmasë të re të poezisë së Naimit, dhe e provon mendimin e shprehur jo rrallë nga studiuesit e veprës së Naimit se ai, Vexhi Buharaja, mund të krahasohet me Nolin në fushën e përkthimeve.

Ndërmjet strukturave ligjërimore paralele, kundërvënëse e përballëse, ose të vendosura në mënyrë aktive në poezi, krijohet fushë e vërtetë e tendosjes ndjenjore e gjuhësore, qark i caktuar i zbrazjeve, shqetësueshëm, të ndërsjella, po ashtu ndjenjore e gjuhësore, një hapësirë e përbashkët, në të cilën veprojnë njëkohshëm reflekset e njësive narrative të kundërvëna dhe të njësive gjuhësore plot dinamizëm. Këto reflekse janë një aspekt i ekzistencës dhe i veprimit të kësaj njëmendësie poetike e gjuhësore, të formësuar mirë, por njëmendësi që nuk ekziston jashtë raportit të ndërndikimeve dhe të njëmendësisë së parrokshme a të paimagjinueshme jashtë kësaj përballjeje.

Zbulimi, gjallërimi dhe drejtimi krijues i këtyre rrezatimeve të padukshme - ndërldhja dhe ndërveprimi – që i lidhin fenomenet edhe në largësi (tokë - qiell) - janë përcaktuesit parësorë të qëllimit të poetit.

Ndonjëherë, krijohet përshtypja se përsëritja, përtëritja dhe dyfishimi i paralelizmave, të shfrytëzuara me tepri, mund të ndikojnë negativisht në shprehjen ekonomike, ndonëse bie në sy menjëherë se kjo është një brengë e zgjidhur, e zgjidhur suksesshëm në të shumtën e herëve nga Naimi. Krijohet, madje, përshtypja se pikërisht përballja a kundërvënia e njësive paralele shndërrohen në një ekonomizim të veçantë, jo vetëm pse ky është veprim shumë i efektshëm për të arritur ndërveprime të caktuara ligjërimore, por edhe pse me përsëritjen forcohen gjysmat e lidhjeve (paralele) dyfishe, për t'u kuptuar më lehtë gjysma tjetër e nënkuptuar. Kjo vlen për të gjithë tipat e paralelizmave, të formësuar qartë, të krijuar në bazë të njëjtësisë, ngjashmërisë ose përdallimit. Ai sikur nuk ka besim në përfundimin e një fjale, të një mendimi. Prandaj, para se të vendosë një subjekt, objekt poetik qoftë edhe hipotetik, ai të udhëzon kah vargu i pandërprerë i pararojave letrare.

Që në vargjet e para krijohet pamja themelore - qielli, hapësira e pafund, bukuria fascinante, frika nga përmasat kosmike, pastaj ajo që i paraprin dhe që e pason, si dhe lidhja midis tyre - sintetizimi: fuqia, arsyeja e ekzistencës, fshehtësia, qielli - burim i jetës, lindja e botës së re, gjithçka i paracaktohet asaj, gjithçka sillet e vërtitet përkryeshëm si një sistem i përsosur, që s'mund ta projektojë kush, pos një fuqi që nuk njihet ndryshe, veç si krijues i gjithësisë - Perëndia. Këtu arrin kulminacionin poezia, ndërsa lexuesi lehtas e vetvetishëm përjeton vlera të reja e të larta të atmosferës poetike e gjuhësore (ndjenja dhe shtimung). Ky përjetim nuk pengon mbikëqyrjen e subjektit poetik. Ai rrjedh lirshëm si në gjithë poezinë e tij, theksueshëm lirike.

Naimi nuk të befason pas çdo vargu e njësie. Ai pa shtrëngesë përsërit forma e gjedhe, të cilat dëshmojnë, pa dyshim, të vlefshme, të paharxhuara me përvojën dhe të palënduara estetikisht me kohën.

Kur në morinë e kaq veçorive të një poezie të frymëzuar, siç është «*Qielli*», veçohen për analizë një tubë të veçantash, në mënyrë të vetëdijshme pranojmë edhe një shqyrtim të kufizuar të saj. Artin e poezisë nuk e bëjnë, dihet, as fjetet e veçanta, madje të trajtuara veçmas, as vlerat e bashkuara. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë, nuk është e parëndësi që të kuptohen e të vlerësohen gjithë vlerat e saj, gjatë hetimit të tyre, e të paraqitet natyra e pranisë së tyre në poezinë dhe mënyra e funksionimit të disa përcaktuesve kryesorë të strukturës poetike e gjuhësore. Poezia «*Qielli*» mundëson analiza të tilla, të përgjithshme, të veçanta, të përimita e të thella dhe, jo vetëm në rrafshet e ndryshme gjuhësore, por edhe në rrafshin e pasurisë së risive burimore.

Qindra e mija vargje të Naimit janë krijuar në përpjekjen për të formësuar shprehjen më të plotë estetike, e cila në rrugën më të shkurtër e më të përshtatshme do ta bartë zërin e tij, idetë e tij, zë dhe ide lehtë të identifikueshëm edhe sot. Një paralajmërim i shkallshkallshëm, i qëndrueshëm, në të vërtetë zëri i tij paralajmëron atë që e ndien ai aq fuqishëm. Ky zë, si strukturë individuale e ligjërit poetik, paraqitet i transponuar në disa rrafshet. Ajo që vjen, i shfaqet poetit para se të jetë gati të hyjë tërësisht në poezi, para se të marrë formën gjuhësore. Shfaqen kështu skajet e temës, të subjektit, të përzgjedhjes poetike e gjuhësore. Çdo gjë lind para lindjes, në mënyrë që të kuptojë se ku gjendet, se ku është i shtrënguar të krijohet e të jetojë, artistikisht e gjuhësisht. Dhe e ndien se ka gjetur terren të përshtatshëm poetik e gjuhësor, për të jetuar e për të mbijetuar si zë i ndërgegjes, i botëkuptimit të poetit, terren i gjetur poetik, sepse e ndihmon muza, terren gjuhësor, sepse i ndihmon shqipja. Nga e ardhmja, ka gjetur mundësi të hedhë vështrimin në paraardhmëri, në të sotmen tonë. Poeti druan nga e panjohura, nga e ardhmja. Në këtë drojë, shqetësim e fërgëllim, imagjinata prek të ardhmen, atë që mund të vijë ose që do të vijë patjetër, dhe i hedh një vështrim poetik asaj që e pret si njeri, botën, në të cilën duhet të zgjohet, i shqetësuar para fatit, pse njeriu është aq i vogël - para Qiellit, para gjithësisë, para Perëndisë, e aq i madh para idealeve, dëshirave, dashurisë. Tejhikimi e bën të tejdukshëm.

Struktura e poezisë është dhënë në dy bashkime të vogla, por me informacione të dendura. Veprimi poetik është atraktiv nga shumë kënde. Poezia fillon me vargjet:

*«Natë e qetë, hëna e bukur plot me dritë,
Fllad i ëmbël, toka e hapur ka stolitë,
Zogu i mëndjes, po më sulet drejt nga qielli,
N'hapësirat plot me afsh e dritë dielli.*

Autori na del aktori qendror që i drejtohet qiellit. Ai thuhet se di gjithë përgjigjet që lidhen me atë det të pakufishëm pyetjesh.

*Ç'është, ç'është kjo - e paana Gjithësi?
Dhe ky rregull dhe ky libër që sheh ti»*

Me pyetje implikon përgjigjen. Shumësia e pyetjeve dhe e përgjigjeve të mundshme, në pikëpamje gjuhësore, nga aspekti i komunikimit të natyrshëm, dalin të papritura, ndërsa invencionit i shprehjes bëhet edhe më i shprehur, por i pritur, për çka poeti vazhdon të pyesë.

Ç'janë vallë këta trupa gjithë zjarre?

Për të dhënë përgjigjen e mundshme imagjinuuese:

*Përplas krahët Kashta e Kumtrit ngadalë,
Posi shtërghi mu në çerdhen ku ka dalë.*

Aktorët e qiellit janë yjet, dritat që lëshojnë ata, sfondi i kaltër qiellor, gjithë ajo botë plot shkëlqim, por shkaktari i disponimit të përnjëhershëm poetik të Naimit është njohja e beftë se Perëndia është ajo që ka «vetëtimë a zjarr vështrimesh, një shkëlqim që s'ka fillim e s'ka mbarim». Epërsinë e Perëndisë karshi njeriut aq të pafuqishëm, autori na e thotë në fund të pjesës së parë: «Se vështrimet e njeriut të shkurtër janë».

E gjithë poezia derdhet gjuhësisht në mënyrë origjinale. Në pjesën e dytë poetin e kaplojnë ndjenja të veçanta. Ai ka përgjigjet e gatshme për pyetjet e shtruara më herët.

«Nuk është kashta e Kumtrit ajo që shpërndan dritë», po «Drita, hiri i Krijuesit të fuqishëm», për të vazhduar menjëherë me vargjet që shprehin qartë botëkuptimin e tij filozofik e fetar: «Çdo gjë vdiçet veç fytyrës së atij».

Në kthesën që pason poeti i drejtohet njeriut. Determinuesi është derivuar në pjesën qendrore të shprehjes. Poeti i kthehet gjendjes zero të sendeve, pastërtisë fenomenale të botës, me shikim të shpeshtë në situatat ekzistenciale kufitare. Krijon dhe mat sipas parimeve e sistemësisë kosmike - tokësore, dhe sipas logjikës ndërnjerëzore e ndërftare.

Se ç' do të bëhen pas kësaj më s' di ç' të them,

Pas kësaj, ah, s' do të jem, jo s' do të jem...

Kështu rishtazi lind një botë e paparë, e papërjetuar dhe e paëndërruar, në të cilën lëvrin, njëjtësën dhe në të njëjtën nyjë lidh qielloren e tokësoren, kalimtarin dhe të përhershmen, të perëndishmen dhe demoniken, njerëzoren e jonjerëzoren, të gjallën e të vdekurën, të largëtën dhe të afërmen, të lashtën e të sotmen, të lartën a sublimen me trivialen, të arsyeshmen dhe jo të arsyeshmen. Antologjika shndërrohet në poetikë.

Dy janë faktorët qendrorë të kësaj poezie: poeti dhe perëndia, ndërsa qendra, në vargje, lëkundet në mënyrë alternative herë te njëri, herë te tjetri bartës i peshës së poezisë. Harmonia ritmike është krijuar nga disa segmente morfologjike, leksematike, po edhe fonologjike. Edhe pse poeti nuk është rob i rregullsisë së ngurtë, që me çdo kusht të vendoset harmonia formale, hetohet se numri i elementeve, i njësisive të tjera dytësore, të rrafshëve të ndryshme, të përdorura këtu, janë edhe në funksion të muzikalitetit, për çka ekzistojnë mjaft të dhëna për analizë gjegjëse. Mjafton të hetohet frekuenca e lartë e fonemave me tonalitetet, po ashtu të lartë, posaçërisht e vokaleve, ndonëse as konsonantet me tonalitet të lartë nuk mbeten prapa; përdorimi i disa leksemave poetike shpesh të papritura, herë edhe arkaike (*vdiret, plaknë e vdarë, mosgjë*); origjinaliteti i theksuar i elementeve leksikore poetike (*e fshehta qiellore, gojë njerëzore, qiell dritëderdhës, pamjedlirtë, madhështi e llagartë, endacake pa qëndrim e pa shtëpi*); rendi i fjalëve, edhe pse i zakonshëm, na del interesant, një sintaksë shpesh e përmbysur me efekte stilistike e mjaft origjinale (*gjer te - e qiellit e fshehta ti mos shko; Një të madhe mençuri fsheh ti në gji; ose kjo e kaltër hapësirë e paanë*).

Vërehen elemente karakteristike që ndeshim edhe në poezinë e sotme, në të vetretë shprehje theksueshëm të lirë poetike.

Poezia «*Qielli*» është një përjetim theksueshëm personal, himn për jetën. Pothuajse çdo gjë është në veprim, çdo gjë funksionon me plot muzikë, me shprehësi tingullore fund e krye.

Harmonia tingullore dhe muzikaliteti shënojnë shkallë të lartë. Numri më i madh i vargjeve përfundon me rrokje të hapur, një karakteristikë e poetëve të traditës, po edhe në një numër poezish bashkëkohore.

Mesazhi poetik i «*Qiellit*» parandihet lehtë, ashtu si përgjithësisht në gjithë poezinë bashkëkohëse të saj. Por, ndërthurja në vargje, gdhendja e përpunimi i shprehjes gjuhësore - poetike, është vetjake dhe karakteristike, prandaj mund të thuhet se me disa modele, sikur ai në poezinë «*Qiellit*», Naimi mund të konsiderohet pararendës i poezisë moderne, ndonëse nuk është lehtë gjithmonë të provohet arsyeja e veprimit të tillë krijues. Pa dyshim se ndërthurja origjinale poetike është edhe fryt i kërkimeve të tij personale. Kridhja në botën mistike, në botën e pagjurmuar, të njohur e të panjohur, në botën e simboleve, dhe mesazhi i poetit ka përcaktuar edhe kërkimin në fushën e faktorëve formalë, pra edhe të atyre gjuhësorë, me të cilët ai na afrohet me poezinë «*Qielli*». Veprimi poetik e gjuhësor, i zbatuar me kaq larmi e përsosmëri në të gjitha nivelet, në gjithë poezinë e tij, paraqet një model të shkëlqyeshëm të gjuhës poetike.

Shefkije ISLAMAJ

THE POEM «QIELLI» OF NAIM FRASHËRI-A MODEL OF THE POETIC LANGUAGE

Summary

The lyric poetry of Naim Frashëri attracts different kinds of analyses. In this insight is dealt with his poem «*Qielli*», written in Persian and masterfully translated by Vexhi Buharaja into Albanian. The poem is interesting, and it represents a very suitable model for linguistic and genre analyses.

This insight is an account for the message of this poem and its fundamental components of linguistic and poetic discourse. What you see in the first reading is parallelisms (parallel attributives and sets of parallel syntagmas), which appear in the whole poem. The Lord represents the symbolic object of the poem, while other symbolic helping objects are represented by the man and the heaven, whose mutual relationship help him create universal concepts. The poetic harmony is due to certain morphologic, lexematic and phonologic segments, and we can find there some characteristic elements of the actual poetry. Poetically and linguistically speaking, this poem is an extraordinary sample of the poetic discourse.

